

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sherri me kamarierin për pak sa nuk u kthye në tragjedi, 3 persona të armatosur hyjnë në lokal - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/sherri-me-kamarierin-per-pak-sa-nuk-u-kthye-ne-tragjedi-3-persona-te-armatosur-hyjne-ne-lokal/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 13:03:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 12:55:45 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	43f0889ac5ba06cbf713ec12cfadd5e5b03f7175ed91f1eddba06f25ee5850ee
TEKSTI	31754f473a8647129804488d6ff86b1b44db87782353964a37a62508a466bc83
PAMJA	9745ce694c1586ce24c9666b57f38e16cfa9decaa0c4c48b530588ef4d68ac7e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a842832778617c91ded0ede4ed163b53596a4d73cbece29051743d26a51956b9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	43295783c846dc5a1340005f94dab0469e006a0ad02e731a1e6c6bc1387a088b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/a842832778617c91ded0ede4ed163b53596a4d73cbece29051743d26a51956b9

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Sherri me kamarierin për pak sa nuk u kthye në tragjedi, 3 persona të armatosur hyjnë në lokal

by editor — September 10, 2026 in Aktualitet, Kronikë, Kryesore

0
SHARES

Share on Facebook

Share on Twitter

Një konflikt i lindur mes një kamarieri dhe dy vëllezërve, Elidon dhe Florjan Gjeloshi, thuhet se është kthyer në tragjedi në fshatin Gomsiqe e Re në Velipojë.

Kamarieri ka njoftuar njerëzit e afërt të tij dhe më pas në ambjentet e lokalit "Arval", kanë mbërritur 3 persona me një "BMW X5" me targa angleze. Dy nga 3 personat kanë qenë të armatosur, ku njëri dallohet të jetë me automatik dhe tjetri me një pistoletë.

Ngjarja e rëndë është regjistruar në pasditen e 6 shtatorit 2026, ku fatmirësisht nuk ka pasur viktime apo qoftë dhe të lënduar. Në pamjet filmike të siguruara nga gazetarit Elton Qyno, dallohen qartë 3 personat, ku dy prej tyre hyjnë të armatosur në ambientet e lokalit.

Klientët që qëndrojnë aty fillojnë të panikosen dhe më pas largohen me shpejtësi, për t'i shpëtuar një përplasjeje me armë. Njëri nga personat që shfaqet në kamerat e sigurisë të lokalit është identifikuar si shtetasi Klevin Nikolli.

Tashmë ky i fundit, së bashku me dy personat e tjerë që shfaqen në këtë video të transmetuar nga "Syri TV", janë identifikuar nga policia dhe shpallur në kërkim policor.

Ndërsa materiali hetimor kundër tyre ka mbërritur në prokurorinë e Shkodrës për akuzën e "Mbajtjes pa leje të armëve dhe municioneve" dhe "Kanosjes me armë".

Në rrëfimin që ka bërë në policinë e Velipojës, pronari i lokalit Valter Përdrecaj, ka sqaruar se në momentin e ngjarjes ka qenë duke qëndruar në ambientet e lokalit të tij që quhet "Arval" në qendër të fshatit Gomsiqe e Re, Velipojë.

Teksa ishte duke qëndruar ai tregon se: "...kam parë një moment se nga një automjet tip BMW X5 me targa angleze, kanë zbritur 3 persona, ku njëri nga ata, e njoh si shtetasin Klevin Nikolli, i cili kishte në dorë një si armë zjarri kallash AK-47, i cili ka zbritur dhe ka ardhur drejt meje. Personi tjetër ka qenë një person që unë e njoh vetëm me emrin Gentjan, nuk e di mbiemrin, dhe ky kur ka zbritur nga mjeti dhe ka hyrë në lokal ka nxjerrë nga brezi një si armë zjarri pistoletë, nuk e di çfarë tipi..." - ka treguar pronari i lokalit Valter Përdrecaj.

Më tej dëshmitari kryesor, tregon se: "...në këtë moment unë kam shkuar përballë shtetasit Klevin Nikolli ku kam kapur armën e këtij personi AK-47, dhe tek po shtyhesha me të për ta nxjerrë nga lokali, i kam hequr

TË FUNDIT

Emigracioni zbraz tregun e punës/ Shqipëria kërkon kujdestarë të moshuarish nga Filipinet

SEPTEMBER 10, 2026

Sherri me kamarierin për pak sa nuk u kthye në tragjedi, 3 persona të armatosur hyjnë në lokal

SEPTEMBER 10, 2026

Vila 650 mijë euro në Palasë, Lala zbulon detajin që lidh Ballukun me biznesmenin: SPAK të marrë në pyetje edhe Ramën

SEPTEMBER 10, 2026

Mashtrimet me Call Center, SPAK ekzekuton 8 masa sigurie, 3 në kërkim

SEPTEMBER 10, 2026

"Jemi me brekë të grisura dhe flasim për AI", Korreshi-Manjës: Në njësitë administrative s'ka as kompjuter

SEPTEMBER 10, 2026

"Pse puthe të dashurin tim"/ U dhunua nga 3 vajzat në Fier, 17-vjeçarja rrëfen ngjarjen

SEPTEMBER 10, 2026

Mish dhe peshk kontrabandë me autobusë nga Greqia, dy të arrestuar në Gjirokastrë

SEPTEMBER 10, 2026

"Hetim për audiopërgjimet e Arben Ahmetajt"/ Qytetarët protestë para SPAK

SEPTEMBER 10, 2026

Ngërçi për pagat përfshin edhe Beratin, Gjykata në bojkot: Trajtohen vetëm masat e sigurisë dhe urdhrat e mbrojtjes

SEPTEMBER 10, 2026

Sot gjyqi në Hagë, Prokuroria: Thaçi tentoi ta pengonte procesin gjyqësor duke ndikuar te dëshmitarët

SEPTEMBER 10, 2026

kanikaton, unë kam bërë një kanikim të armës, por nuk e kam vënë nënese kishte pritur në gojë...

Sipas rrëfimit të pronarit të lokalit ai i ka marrë armën "AK-47" nga dora dhe nuk e di kujt ja ka dhënë, pasi siç thotë ai ishte i frikësuar.

"...por në atë moment Klevin Nikolli, ka nxjerrë nga brezi një armë tjetër tip pistoletë, të cilën e ka drejtuar nga personat me të cilët kishte bërë fjalë që unë i njoh me emrat Elidon Gjeloshi dhe Florjan Gjeloshi, dhe janë klienta në lokalin tim..."- ka treguar dëshmitari.

Më tej siç duket dhe në pamjet filmike këta persona janë shpërndarë nga lokali dhe pas disa momenteve ka shkuar policia e Velipojës, duke nisur kryerjen e veprimeve hetimore.

Sipas hetimeve të kryera ngjarja në fjalë lidhet me një konflikt që kishte ndodhur 1 orë para shfaqjes së personave me armë, ku vëllezërit Elidon dhe Florjan Gjeloshi, janë konfliktuar me kamarierin e lokalit "Arval" në Velipojë./ Syri Tv

Previous Post

Vila 650 mijë euro në Palasë, Lala zbulon detajin që lidh Ballukun me biznesmenin: SPAK të marrë në pyetje edhe Ramën

Next Post

Emigracioni zbraz tregun e punës/ Shqipëria kërkon kujdestarë të moshuarish nga Filipinet



editor

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencia dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

- Aktualitet
- OP-ED
- Politike
- Rajon
- Showbiz
- Sociale
- Shëndet
- Sport

MË TË KLIKUARAT



EMRAT/ Goditet rrjeti i drogës në Sarandë, 20 të arrestuar. Sekuestrohen kokainë, kanabis dhe armë

01

0 SHARES



Identifikohet shqiptari i vrarë në Itali/ E lidhën dhe e ekzekutuan në makinë, automjetin më pas e hodhën në lumë

0 SHARES



Zjarr masiv në Fier/ Flakët përpijnë me shpejtësi pyllin e Çërnilës

0 SHARES